

**VENDIM**  
**Nr.732, datë 1.7.2009**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR**  
**VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 1 e vendimit nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 2629 punonjës, i përcaktuar sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| <b>Grupi</b> | <b>Emri i institucionit</b>                                    | <b>Nr.punonjësve</b> |
|--------------|----------------------------------------------------------------|----------------------|
| 02           | Kuvendi i Shqipërisë                                           | 11                   |
| 03           | Këshilli i Ministrave                                          | 1                    |
| 04           | Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës               | 58                   |
| 05           | Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  | 213                  |
| 06           | Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | 815                  |
| 10           | Ministria e Financave                                          | 49                   |
| 11           | Ministria e Arsimit dhe Shkencës                               | 113                  |
| 12           | Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve            | 22                   |
| 13           | Ministria e Shëndetësisë                                       | 51                   |
| 14           | Ministria e Drejtësisë                                         | 30                   |
| 15           | Ministria e Punëve të jashtme                                  | 16                   |
| 16           | Ministria e Brendshme                                          | 562                  |
| 18           | Shërbimi Informativ Shtetëror                                  | 40                   |
| 20           | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave                            | 30                   |
| 25           | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta | 83                   |
| 26           | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave      | 140                  |
| 28           | Prokuroria e Përgjithshme                                      | 5                    |
| 30           | Gjykata Kushtetuese                                            | 2                    |
| 31           | Agjencia Telegrafike Shqiptare                                 | 3                    |
| 50           | INSTAT                                                         | 378                  |
| 63           | Këshilli i Lartë i Drejtësisë                                  | 2                    |
| 77           | Autoriteti i Konkurrencës                                      | 2                    |
| 82           | Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit                             | 1                    |
| 87           | Institucione të tjera qeveritare                               | 2                    |
|              | <b>TOTALI</b>                                                  | <b>2629</b>          |